

**SUPREME COURT OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL  
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së  
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-45/11

Prishtinë,  
6 Shtator 2011

Në çështjen ligjore

Ž.O.

*Paraqitësi i kërkesës/Palës përgjegjëse në ankesë*

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, Anne Kerber dhe Sylejman Nuredini, Gjyqtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/55/2009 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 17774), të datës 15 dhjetor 2009, pas seancës gjyqësore të mbajtur me 6 Shtator 2011, mori këtë

**AKTGJYKIM**

- 1- Refuzohet si e pabazuar ankesa e Ž.O.
- 2- Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore i Kosovës KPCC/D/A/55/2009 i datës 15 dhjetor 2009, për sa i përket lëndës së regjistruar me Nr. KPA17774.
- 3- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 80 (tetëdhjetë) euro, brenda afatit prej 90 ditë nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

### **Përmbledhja e çështjeve faktike dhe juridike:**

Më 9 janar 2007, Ž.O. ka paraqitur kërkesë Agjencionin Kosovar të Pronës (AKP) ku kërkonte vërtetimin e të drejtës së tij pronësore dhe ri-posedimin e ngastrës kadastrale nr. 54/4 , me kulturë të klasit të dytë, në vendin e quajtur “Oraške Livadže”, zona kadastrale e Brezhanik-ut, të regjistruar në fletën poseduese nr. 139 në Komunën e Pejës, me një sipërfaqe prej 0, 03, 68 ha. Ai ka theksuar se kjo paluajtshmëri i është uzurpuar nga personat e panjohur dhe këtë pronë e ka humbur për shkak të rrethanave të luftës në vitet 1998/99.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai i ka dorëzuar AKP-së këto dokumente:

- Çertifikatën e vdekjes lëshuar me datë 31 December 2002, që tregon se A.O. ka vdekur me 9 Maj 1994;
- Çertifikata e vdekjes e P.O. emri i vajzërisë K., që tregon se ajo ka vdekur me 6 Shkurt 1993;
- Kjo çertifikatë e lëshuar me 4 Korrik 2011 dëshmon se ai është djali i A.O. dhe P.K.;
- Vendimi i trasgëgimise T.nr. 29/02 lëshuar me 26 Nëntor 2002 nga gjykata paralele “Gjykata Komunale e Pejës” pas vdekjes së A.O. dhe P.K., ofron të dhënën se ai është një nga trashëgimtarët e parces objekt kontesti;
- Deklarata e nënshkruar me 6 Korrik 1984 nga dy dëshmitar duke pohuar se prindërit e Ž.O. kishin fermë në fshatin Brezhanik.

Ž.O. në kërkesën e parashtruar ka përmendur të gjithë trashëgimtarët e tjerë që janë përmendur në vendimin e trashëgimisë, si palë të interesuara, prandaj ai në këtë kërkesë ka vepruar në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare sipas nenit 1.2 të Aneksit II .të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-079 mbi zgjidhjen e ankesave me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Raporti i përpunimit të kërkesës së AKP-ës vëren se bazuar në fletën poseduese nr. 139 të datës 19 Shkurt 2008, lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunë së Pejës, e siguruar në mënyrë ex officio, ngastra kadastrale nr. 54/4 ishte regjistruar në emër të bartësit të së drejtës pronësore, A.O., dhe se nuk ka pasë kurfarë ndryshimesh lidhur me këtë paluajtshmëri deri në datën e raportimit. Kjo gjithashtu tregon se edhe pse njoftimi i kërkesës së parashtruar është bërë duke vendosur njoftimin në parcelë me 6 Dhjetor 2007 dhe publikimi i saj është bërë me 24 Dhjetor 2007, nuk është identifikuar asnjë palë përgjegjëse dhe se paluajtshmëria nuk ka qenë në shfrytëzim. Për më

shumë, mbrenda periudhës kohore nga data e publikimit, nuk ka pasë asnjë përgjegje nga ndonjë palë përgjegjëse në lidhje me palujtshmërinë që është objekt kontesti.

Raporti i përpunimit të kërkesës i AKP-ës ka theksuar se humbja e posedimit me datë 12 Qershor 1999 për shkak të situatës së përgjithshme në Kosovë dhe se e drejta pronësore nuk ka mund të ushtrohet për shkak të rrethanave lidhur ose si rezultat i konfliktit të armatosur që ka ndodhur midis 27 Shkurt 1998 dhe 20 Qershor 1999.

KKPK-ja me vendimin e tij KPPK/D/A/55/2009 të datës 15 Dhjetor 2009, ka vendosur se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar të drejtën e pronësisë së babait të tij në parcelën objekt kontesti, se ai ka të drejtën e posedimit në këtë palujtshmëri dhe se nëse ndonjë person uzurpon këtë palujtshmëri duhet të liron atë mbrenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit.

Vendimi i KKPK-ës është pranuar nga Ž.O. me fatë 15 Mars 2011. Në të njejtën datë Ž.O. në AKP-ë ka parashtruar kërkesë për administrimin e palujtshmërisë. Pastaj, me datë 28 Mars 2011 ai ka ushtruar ankesën. Ai ka shpjeguar se ka paraqitur kërkesën e tij në AKP me qëllim të ndryshimit të vendimit T.nr. 29 dhe 30/02 lëshuar nga gjykata paralele e ashtuquajtur “Gjykata Komunale e Pejes” me datë 26 Nëntor 2002. Ai ka pohuar se kjo gjykatë ka bërë gabim për sa i përket sipërfaqes së ndarë secilit trashëgimtar dhe ka propozuar që sipërfaqja prej 0, 15, 94 ari t’i ndahet secilit nga shtatë trashëgimtarët e de cujus-it A. dhe P.O..

### **Arsyetimi ligjor:**

Gjykata Supreme konsideron se aktgjykimi i ankimuar sipas dispozitave ligjore të Nenit 13.3 (c), të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar nga Ligji Nr. 03/L-079 dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore ka gjetur se ankesa është e pabazuar.

Gjykata Supreme, duke marrë parasysh gjendjen faktike të lëndës në fjalë gjen se vendimi KPPK/D/A/55/2009, i datës 15 Dhjetor 2009 i cili ka shqyrtuar kërkesën KPA17774, e cila është vendosur mbi gjendjen e vërtetuar drejtë dhe te plotë faktike dhe duke zbatuar drejtë ligjin material.. KKPK-ja në vendimin e ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe vlefshme për vendimarrje të drejtë në këtë lëndë dhe si të tilla ato janë pranuar edhe nga kjo gjykatë. Vendimi i ankimuar nuk përmban ndonjë nga shkeljet esenciale të dispozitave ligjore të procedurës kontestimore e cila do të duhej vërejtur exo officio nga kjo gjykatë në pëputhshmëri me Nenin 194 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-ës). Vlerësimi i fakteve dhe arsyetimi ligjor i KKPK-ës, sipas kësaj gjykate është

i drejtë dhe i ligjshëm, duke dhënë shpjegime dhe sqarime të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Prandaj, pretendimet ankimore të ankuesit dalin si të papranueshme.

Në të vërtetë kërkesa e paraqitur e cila është paraqitur në AKP është kërkesë për vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimit në këtë palujtshmëri, i cili kishte humbur për shkak të konfliktit të armatosur të ngjarë në Kosovë. Asnjëherë pranë AKP-ës nuk është dorëzuar ndonjë padi për ndryshimin e vendimit mbi trashëgimin.

Nëse ndonjë kërkesë do të paraqitej, do të refuzohej për shkak se çështjet e trashëgimisë nuk mund të ishin lëndë trajtimi dhe vlerësimi nga Kolegji i Apelit të AKP-ës i Gjykatës Supreme, sipas dispozitave të parapara në Nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Në pajtim me këtë dispozitë, KKKP-ja dhe Gjykata Supreme, paneli kompetent mbi ankesat e ushtruara kundër vendimeve të KKP-ës ka kompetencë në kërkesat e paraqitura për të drejtën e pronësisë në lidhje me palujtshmërinë private në rastet kur paraqitësi i kërkesës nuk është në gjendje të ushtroj të drejtat pronësore për shkak rrethanave direkt të lidhura ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në mes të 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999. Prandaj, propozimi i ankuesit me qëllim të përmirësimit të gabimeve të pretenduara të vendimit mbi trashëgimisë T.nr. 29 dhe 30/02, të datës 26 Nëntor 2002, të gjykatës paralele të ashtuquajtur “Gjykata Komunale e Pejes” nuk ka mund të shqyrtohet në këtë procedurë.

Ky aktgjykim nuk paragjykon të drejtat e ankuesit dhe interesimin e tij të paraqes kërkesë në gjykatën kompetente.

### **Shpenzimet e procedurës:**

Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhëresës Administrative (UD) 2007/5, e amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët përjashtohen nga shpenzimeve e procedurës të zhvilluar pranë Sekretarisë Ekzekutive dhe të Komisionit.për Kërkesa Pronësore të Kosovës.

Sidoqoftë, një përjashtim i tillë nuk parashikohet në procedurën para Gjykatës Supreme.

Rrjedhimisht, regjimi normal i shpenzimeve gjyqësore siç parashihet me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK, 3 tetor 1987) dhe sipas UD Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi Unifikimin e Taksave Gjyqësore, zbatohet ndaj procedurës së zhvilluar para Gjykatës Supreme.

Prandaj, shpenzimet gjyqësore si në vijim aplikohen në procedurën e tanishme të ankesës:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës ( Neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa nga tarifa gjyqësore për marrjen e aktgjykimit ( Nenet 10.21 dhe 10.1 të UA 2008/2), duke pas parasysh se vlera e pronës në fjalë, siç ceket në raportin e vlerësimit të Komunës së Pejës në kërkesën e Gjykatës Supreme, është vlerësuar 2000€: 20€

Këto taksa gjyqësore i bart parashtruesi i ankesës në cilësinë e palës gjyqëdhënëse.

Në përputhje me Nenin 46 të Ligjit mbi Shpenzimet Gjyqësore, afati për pagesën e taksave nga tarifa në fjalë nga personi i cili ka venqëndrim ose vendbanim jashtë shtetit nuk mund të jetë me i vogël se 30 ditë dhe më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos se në rastin konkret, taksat nga tarifa gjyqësore nga ankuesi duhet të paguhen në afat prej 90 ditësh nga dita e dorëzimit atij të këtij aktgjykimi.

### **Këshillë juridike**

Sipas nenit 13.6 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 e amendamentuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe si i tillë nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura dhe në bazë dispozitave të nenit 13.3(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i amendamentuar me Ligjin 03/L-079, u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

**Nënshkruar nga: Antoinette Lepeltier-Durel, Kryetare e Kolegjit, EULEX**

**Nënshkruar nga: Anne Kerber, Gjyqtare e EULEX-it**

**Nënshkruar nga: Sylejman Nuredini, Gjyqtar**

**Nënshkruar nga: Urs Nufer, Regjistues**